



Është Hapur Tashmë Aplikimi për Kopsht!

Të nderuara familje,

Është hapur tashmë aplikimi për kopsht! Nëse jetoni në Qytetin e Nju Jorkut dhe keni një fëmijë të lindur në vitin 2021, mund të aplikoni për kopsht deri në afatin e **23 janarit 2026!**

Ju lutemi vini re se pranimi në kopsht nuk bëhet sipas parimit “kush vjen i pari, gjen vend i pari”, pra nuk ka përparësi nëse aplikoni herët. Të gjitha aplikimet e marra deri në afat trajtohen në mënyrë të barabartë, bazuar në prioritetet e pranimi.

Ju mund të aplikoni në një nga tre mënyrat:

- **Online me [MySchools.nyc](https://www.myschools.nyc.gov)**—E rekomanduar!
 - **Keni tashmë një llogari?** Nuk keni nevojë të krijoni një llogari të re, mund të përdorni të njëjtën llogari. Nëse nuk e shihni fëmijën tuaj në faqen kryesore (dashboard), klikoni “Add a Child (Shto një Fëmijë)”.
 - **Nuk keni një llogari?** [Krijoni llogarinë tuaj sot](#). Do të përdorni MySchools për të kërkuar shkolla fillore, për të aplikuar për kopsht, dhe për të marrë letrën e ofertës së fëmijës suaj. Shikoni videot udhëzuese për të mësuar [se si të krijoni llogarinë tuaj MySchools](#) dhe [si të aplikoni](#).
- **Me telefon, në 718-935-2009.** Na telefononi nga e hëna deri të premten, 08:00–18:00.
- **Kontakttoni një Qendër Mirëseardhjeje për Familjet.** Mësoni më shumë në schools.nyc.gov/FWC.

Shërbimet e përkthimit dhe interpretimit janë të disponueshme në çdo mënyrë aplikimi.

Si përkujtesë, ky aplikim përdoret për të aplikuar për të gjitha programet e kopshtit, përfshirë Kopshtin e zakonshëm (Kindergarten), Kopshtin për të Talentuar dhe të Dhuruar (Gifted & Talented – G&T), Programet Dygjuhëshe (Dual Language), Programet STEM të Distriktit 24. Mund të renditni po aq zgjedhje sa jeni të interesuar t’i ndiqni, përfshirë shkollat që ndodhen jashtë zonës ose distriktit tuaj. Nxënësit që jetojnë në zonën përkatëse kanë përparësi kryesore të ndjekin shkollën në zonën e tyre.

Sigurohuni që t’i rendisni programet sipas rendit real të preferencave, edhe nëse ato janë në të njëjtën shkollë. Për shembull, nëse dëshironi që fëmija juaj të ndjekë programin G&T më shumë se një program tjetër kopshti, renditeni më lart në aplikim. Prioriteti i pranimi të fëmijës nuk ndikohet nga rendi në të cilin i vendosni zgjedhjet në aplikim.

Mësoni për shkollat që ju interesojnë duke marrë pjesë në një open house (ditë e hapur) ose në një tur të shkollës. Disa shkolla publikojnë datat e open house dhe tureve në [Kalendarin e Eventeve të MySchools](#). Gjithashtu, mund të vizitoni faqen e internetit të shkollës ose të kontaktoni direkt me ta për të mësuar më shumë.



Dëshironi të mësoni më shumë? Na u bashkoni në takimet tona virtuale për pranimet në shkollën fillore. Për data dhe detaje, vizitoni [faqen tonë të eventeve](#). Në javët në vijim, do t'ju dërgojmë njoftime dhe kujtesa të reja.

Keni pyetje? Na telefononi në 718-935-2009 ose na dërgoni e-mail në ESEnrollment@schools.nyc.gov.

Ju urojmë më të mirat,

Skuadra e Pranimeve në Arsimin Fillor

Ju është përcjellë ky email nga një mik? Sigurohuni të regjistroheni në listën tonë të postës elektronike për pranimet në kopsht, në schools.nyc.gov/SignUp.

Nëse nuk dëshironi më të merrni e-maile nga një apo nga të gjitha listat tona, ju lutemi të klikoni [këtu](#) për t'u çregjistruar.